

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	112/24
Nr. i fq. / Br. st.	- 6 -
Datoe / Datum	13.06.2024
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

### PROCESVERBAL

**në mbledhja e V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17 maj 2024 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 12:10.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF-së).

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe drejtoret e drejtive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo dha disa sqarime lidhur me pikat që kanë qenë në plan të punës për këtë muaj e nuk janë proceduar. Lidhur me Qarkoren Buxhetore, ajo tha se e kemi një arsyetim nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ku qarkorja ende nuk është lëshuar nga Ministria e Financave. Informata lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve nuk është proceduar, për shkak se pyjet kanë kaluar nën menaxhim të Agjencisë së Pyjeve. Propozim-vendimi për dekorata dhe mirënjojje nuk na është proceduar ende, arsyetimi i drejtorisë është se komisioni ende nuk e ka përfunduar punën e tyre.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – lidhur me Propozim-vendimin për dekorata dhe mirënjojje, ajo tha se në bazë të statutit të komunës, neni 17, pika 5, thuhet që kuvendi i komunës ndan dekorata dhe mirënjojje për personalitetet të ndryshme. Kjo pikë ka qenë e planifikuar në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës, kurse afati i procedimit të materialit për KPF ka qenë 5 maj 2024. Prandaj, nuk kemi ndonjë informacion me shkrim lidhur me këtë çështje. Si anëtare e kuvendit nuk kam informacione për përbërjen e komisionit që e cekët më herët. Nuk është e re për kuvendin dhe as për këtë qeverisje lokale, mosfunkcionimi normal i këtij kuvendi dhe shkelje e vazhdueshme e rregulloreve, statutit, e në shumë raste edhe LVL-së. Në bazë të nenit 19, të Rregullores për Dekorara, Kryetari i Komunës për çdo fillimvit e formon komisionin për shqyrtimin e propozimeve dhe iniciativave për dekorata me mandat njëvjeçar. Gjatë hulumtimit tim në faqen zyrtare të komunës, tek rubrika “aktet e kryetarit”, nuk e kam gjetur askund që ky komision është themeluar në fillim të këtij viti. Dita e Çlirimt eshtë shumë e rëndësishme dhe e veçantë për komunën tonë dhe i gjithë komunitetit. Shumë njerëz e kanë dhënë jetën e tyre, që ta gjelqojnë të tjerët lirinë. Prandaj, eshtë ndër për institucionet e komunës t'i nderojnë personalitetet e komunës sonë, e veçanërisht në këtë datë që parashihet me aktet nënligjore të komunës. Pra, nga pikat më rëndësishme mos t'ë vjen në këtë seancë, duke e ditur që është muaji i fundit që këto propozime duhet të shqyrtohen nga kuvendi, që më datën 17 qershor të jenë të përfunduara. Ju si kryesuese duhet t'ju bëni drejtive presion që t'i sjellin materialet. Ajo propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e kuvendit.

Propozimi tjetër që po kërkoj ta fusni në rend të ditës është që: "Ish arkivi i qytetit të destinohet për sektorin e trashëgimisë kulturore". Ne si komunë duhet t'i ruajmë dhe mbrojmë me fanatizëm këto objekte që na kanë mbetur dhe që na identifikojnë si qytet. Tash e dy vite, drejtoria e ka në plan të projekteve kapitale, restaurimin e këtij objekti, ish-arkivit të qytetit (ish fabrikës së vajit), që është në fazat e prokurimit përfundimin e procedurave për restaurimin e tij. Prandaj, duke i ditur nevojat e sektorit për trashëgimi kulturore, më kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, po propozoj që të futet në rend të ditës dhe të procedohet për kuvend.

**Melihate Basholli-Latifë, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – tha se sa herë që nuk po respektohet Plani i Punës së Kuvendit, shigjetat po shkojnë në drejtëm të Kryesueses së kuvendit. Por, ju e dini që kryesuesja mund të kërkojë dhe vazhdimisht kemi kërkuar dhe kërkojmë që t'i sjellin materialet. Edhe pse, gjithë po e përsëris këtë sqarim, drejtorët e drejtorive përveç që e kanë planin e punës, përmes sekretarisë ua rikujtojmë me e-mail që t'i sjellin materialet, por edhe në mënyrë verbale. Lidhur me propozimin për dekorata, kemi kërkuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport të na e dërgon një arsyetim me e-mail, që nuk po e sjellin propozimin, por as këtë e-mail nuk e kemi marrë. Ne do të kërkojmë përsëri që materiali të na vjen për kuvend.

Lidhur me propozimin për ish-arkivin të futet në rend të ditës, nuk është në plan të punës dhe duhet të konsultohemi me kryetarin dhe drejtoritë kompetente lidhur me koston buxhetore. Propozimi im do të ishte që të bashkëpunohet me institucionet relevante dhe të vjen si lëndë e kompletuar.

**Fatmire Cecelia, anëtar e KPF-së** – ky është një objekt që është në procedurat e prokurimit për restaurim dhe nuk ka nevojë për kosto financiare ekstra për të bërë një zyrë të trashëgimisë kulturore. Kisha kërkuar edhe nga Drejtoria për Inspektime që të largohen kontejnerët afér këtij objekti.

**Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** – lidhur me objektin e ish-arkivit, ai tha se fleta poseduese dhe kopja e planit janë në pronësi të komunës. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport i ka marrë të dhënat nga drejtoria jonë. Çështja e kontejnerëve është në kompetencë të NPL "Përparimi".

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se as në këtë mbledhje nuk e kemi raportin e NPL "Përparimi". Ndoshta jam bërë i tepërt me këtë çështje, por kemi nevojë që të kemi informata nga kjo ndërmarrje. Punëtorët e kësaj ndërmarrje çdo ditë po irrezikohen nga mjetet e vjetruara, ku si pasojë e kësaj, para një javë janë lënduar dy punëtorë. Ai kërkoi përsëri që në seancë të shkarkohet komisioni i aksionarëve.

Edhe në mbledhjet tjera kam kërkuar që të ndryshohet Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave, sa i përket tarifave të bizneseve dhe se ende nuk kemi asnjë rezultat për plotësim-ndryshimin e saj.

**Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike** – deklaroi se në faqe të komunës është drafti i rregullores dhe ka qenë njoftimi për konsultim publik, ku asnjë biznes dhe asnjë qytetar nuk kanë qenë të pranishëm.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – unë vetëm kam kërkuar që të formohet komisioni për ndryshimin e kësaj rregullore dhe ky draft të vjen në kuvend, në mënyrë që të ndryshohen ato tarifa të bizneseve dhe mos të trajtohen të gjitha bizneset njëjtë.

**Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** – kërkoi që për kuvend të futet në rend të ditës “Propozim – vendim për formim të komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim”.

*Komiteti për Politikë dhe Financa me tri (3) vota “për”, dy (2) “kundër” dhe dy (2) “abstenime” e futi në rend të ditës që: “Ish arkivi i qytetit të destinohet për sektorin e trashëgimisë kulturore”.*

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

#### **R E N D   D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.04.2024
  2. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për rregullimin e kanalizimit në rr. “Enver Musa” në Vushtrri
  3. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Ndërmarrjes Regionale të Mbeturinave KRM “Uniteti” për vitin 2024
  4. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së – dega në Vushtrri
  5. Ish arkivi i qytetit të destinohet për sektorin e trashëgimisë kulturore
  6. Pyetje dhe përgjigje
- 
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.04.2024.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 15.04.2024.***

2. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për rregullimin e kanalizimit në rr. “Enver Musa” në Vushtrri.

**Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** – tha se në bazë të kërkesës së anëtarëve të kuvendit, e kemi plotësuar këtë propozim dhe vizatimet janë më të qarta. Komuna e Vushtrrisë gjatë realizimit të projektit për rregullimin e kanalizimit, ka vendosur gypat në pronën private.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – e falënderojmë drejtorin që e ka plotësuar këtë propozim, sepse reagimet e anëtarëve të kuvendit në seancë kanë qenë për shkak të disa paqartësive që kanë munguar në material. Prandaj, e përkrahu këtë propozim që ta procedojmë për kuvend.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për” dhe dy (2) “abstenime”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Ndërmarrjes Regionale të Mbeturinave KRM “Uniteti” për vitin 2024.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se të gjitha aktivitetet e kompanisë “Uniteti” kanë kaluar në NPL “Përparimi”. Kryetari na kishte thënë që kanë mbetur disa aktivitete në kompaninë “Uniteti”, por nuk e di kush i kryen. Kjo, sepse sa e di unë nuk ka punëtorë në kompaninë “Uniteti” në Vushtri.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – deklaroi se nuk duhet ngutur që të humben aksionet në këtë ndërmarrje. Sepse, në të ardhmen mund të zgjerohet gama e shërbimeve në këtë ndërmarrje, por edhe për komunën për të marrë shërbime shtesë. NPL “Përparimi” po ka shumë vështirësi të funksionimit, deri në pasiguri të punëtorëve për mbijetesë, për shkak se iu kanë vonuar edhe pagat, por edhe në mungesë të mjeteve motorike. Prandaj, raportimi duhet të vazhdojë, por edhe duhet t’i ruajmë aksionet në kompaninë “Uniteti”.

**Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike** – si kryesues i komisionit të aksionarëve e them që aksionet në kompaninë “Uniteti” janë ashtu qysh kanë qenë. I vetmi shërbim që kemi me këtë kompani është larja e rrugëve, ku njësia në Mitrovicë e kryen këtë shërbim në bazë të marrëveshjes. Kurse, tatimet paguhen njëjtë.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së – dega në Vushtri.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – do ta analizojmë këtë kërkesë dhe do të dalim me një propozim për shumën financiare.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – A ka përfunduar ky si projekt? E mjetet po ndahen pas përfundimit të projektit. A është pronë komunale vendi ku është ndërtuar lapidari? Neni 17 i Statutit e parashevë që caktimi i lokacionit për ndërtimin e lapidarëve bëhet nga kuvendi.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – Ne e dimë që ky projekt është i përfunduar dhe më ka pëlqyer forma se si e kanë punuar, ku ka ndriçim edhe gjatë natës. Parimisht, ne e mbështesim si kërkesë që të shkojë në kuvend, për shkak të pozicionit që na vendosin neve me këto kërkesa. Por, a është forma e duhur kjo që e ka bërë shoqata, nuk është forma e duhur dhe është sfiduese. Edhe shoqatës duhet t’i tregoni që kjo nuk është forma e duhur. Sepse, shumë familje kanë kërkesa për ngritjen e lapidarëve për dëshmorë. Duhet të ketë një trajtim të barabartë për të gjithë. Kërkesa e familjes së dëshmorit, Bahri Kuqi është sillur nëpër administratë të kuvendit apo drejtorive përkatëse. Plot familje kanë kërkesa të tillë për ngritje të lapidarëve.

Prandaj, do të ishte mirë që të bëhet një rregull i pashkruar që komuna t’i ndërtojë nga dy apo tre lapidarë në vit, sipas radhës alfabetike të dëshmorëve dhe të përfundohet për të gjithë.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se po i rekmandojmë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa që ta përgatis një propozim për caktimin e shumës financiare dhe ta procedojë në kuvend.

**Mentor Hasani, anëtar i KPF-së** – tha se nuk e ka ditur që ky lapidar është i përfunduar. Në fshatin Druar ka edhe dëshmorë tjerë dhe çfarë do të bëjmë me dëshmorët tjerë. Nëse nuk ka përfunduar ende ky lapidar, ndoshta do të ishte mirë që t'i propozohet Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve që t'i fusin emrat e të gjithë dëshmorëve të Druarit dhe të vendosen në një vend në fshat dhe kjo do të ishte ide e mirë për të gjitha fshatrat. Kjo është çështje e ndjeshme dhe se ne i përkrahim këto kërkesa pa asnjë dilemë, por e lus shoqatën që mos të bëj kërkesa të tillë individuale.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që Drejtoria për Buxhet dhe Financa ta përgatis propozimin për caktimin e shumës financiare dhe ta procedojë për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

5. Ish arkivi i qytetit të destinohet për sektorin e trashëgimisë kulturore.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – tha se nuk desha ta fus në rend të ditës këtë pikë, sepse desha që të jetë e përgatitur. Ajo tha se është skeptike se do të realizohet në kohë të shkurtër. Por, meqë u shtua në rend të ditës, material nuk kemi, përvèç atë që e tha Fatmirja. Mendimi im është që këtë pikë ta votojmë për ta proceduar në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të analizohet implikimi buxhetor dhe çështja e pronës. Pastaj, si material i kompletuar të na vjen në seancë të kuvendit.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – nuk e di çka është kjo tendencë që çdo propozim që bëjë i jepni kahje tjetër. Kjo pikë u votua që të diskutohet dhe të procedohet për kuvend. Prandaj, deri në seancë mund ta përgatis arsyetimin për këtë propozim. Ajo tha se nuk ka diskutabile në aspektin pronësor, sepse kjo është pronë e komunës. Po ashtu, nuk ka implikime buxhetore, sepse është në procedura të prokurimit për restaurim.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – theksoi se nuk ka tendencë ndaj askujt dhe nuk i jap kahje asnjë propozimi. Propozime kemi të drejtë të japim, por ato duhet të jenë të përgatitura. Prandaj, propozimi yt nuk ka qenë i përgatitur për sot. Ne mund të japim rekomandim që të përgatitet si pikë e rendit të ditës për seancën e radhës së kuvendit. Por, a mund ta përgatisin drejtoritë, është pastaj çështje e tyre.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – po e them me përgjegjësi të plotë që gjatë javës së ardhshme do ta sjell propozimin me shkrim.

**Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike** – deklaroi se ky objekt është në gjendje të mjerueshme. Prandaj, për këtë janë planifikuar mjetet për ta restauruar. Fillimisht, le të bëhet restaurimi e te shohim tutje, ndoshta ka nevojë për t'u destinuar për ndonjë çështje më të rëndësishme.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – po bëhen pa nevojë këto diskutime jokorrekte. Anëtarët e KPF-së kanë të drejtë të japim propozime për kuvend. Ne e diskutuam dhe si

çështje mendoj që duhet të vjen në kuvend. Pastaj, mbetet në vullnetin e anëtarëve të kuvendit se çka do të vendoset.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tri (3) vota “për” dhe katër (4) “kundër”, nuk rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Pyetje dhe përgjigje.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – pyeti se deri ku ka shkuar procesi i shujtave për shërbyesit civilë dhe për zjarrfikës?

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se në këtë seancë do të kërkojë që të jetë pikë e rendit të ditës. Edhe nëse nuk është pikë e rregullt e rendit të ditës (rendi i ditës bëhet në bashkëpunim me kryetarin e komunës), që nuk besoj që do të jetë kundër as kryetari. Por, nëse nuk do të jetë pikë e rregullt në rend të ditës, do ta marr materialin me vete dhe do të propozojë në seancë që të futet në rend të ditës dhe pres përkrahjen e anëtarëve të kuvendit.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tha se kryetari nuk na e sjelli ende analizën financiare (që premtoi vet) lidhur me rritjen e subvencioneve përfshirë e porsalindur. Ju si kryesuese keni një përgjegjësi administrative lidhur me zbatueshmërinë e vendimeve të kuvendit (së paku moralisht ta përcjellni zbatueshmërinë e tyre), sepse zbatueshmëria direkte është nga qeveria komunale. Po flas për vendosjen e pllakës së teatrit të qytetit me emrin e të nderuarit, të ndjerit “Adem Mikullovci”. Jemi detyruar një herë si grup kuvendar që pllakën ta vendosim vetë. Shpresoj që mos të vjen prapë e njëjtë situatë që ta vendosim ne vetë. Prandaj, po kërkoj nga drejtoria përkatëse që ta vendos pllakën, e mos na vendosni në situatë të palakmueshme. Nuk kërkohet shumë angazhim, e as shumë shpenzim, por vetëm kërkohet vullnet për t'u kryer një çështje e tillë.

Mbledhja përfundoi në orën **13:20**.

**Bujar Klinaku**



Procesmbajtës

**Melihate Basholli - Latifi**

Kryesuese e KK-së dhe KPF- së

